

Grimca Krishtlindje (pjesa 2 nga 5)

Grimca Dashurie

Mirë se erdhët në festimin e kishës sonë! Jemi në pjesën e dytë të serisë "Grimca Krishtlindje". Cili ka qenë kujtimi i Krishtlindjes më i bukuri ndër vite?

“Kurrë s'do ta harroj periudhën kur kam shkuar të shërbej në Kosovë. Ishte data 24 dhjetor dhe një vajzë kosovare pranoi Jezusin. Sytë e saj shkëlqenin kur ne flisnim për Jezusin. Në qiell bëhej festë, por dhe në zemrën time ishte festë akoma më e madhe. Në atë Krishtlindje u bëra me një motër më shumë në Krishtin. Ku ka më bukur?”

“Për mua ka qenë viti 1993. Ne ishim në Pallatin e Kulturës në Lushnjë dhe kemi pasur takimin më të madh ungjillizues, ku salla ka qenë e tejmbushur. Ka qenë emocionuese.”

“Për mua, është Krishtlindja e vitit 2010, sepse e kuptova 100% kuptimin e festës së Krishtlindjes dhe ia dorëzova jetën time Perëndisë.”

“Ishte Krishtlindja më e bukur kur, si grup i krishterë, kemi festuar dhe kemi ndarë me njëri-tjetrin sfidat që kemi kaluar gjatë vitit dhe bekimet e Perëndisë përgjatë vitit. Ishte inkurajuese të dëgjoje se si Zoti vepron në mënyra të ndryshme tek të gjithë ata që e thërrasin emrin e Tij dhe i binden zërit të Tij.”

Faleminderit për grimcat e gëzimit që ndatë me ne!

Sot jemi në pjesën e dytë të serisë dhe do të shikojmë:

Grimca Dashurie

Këtë bluzën e kam blerë para shumë vitesh. Dhe e kam veshur për shumë kohë, derisa u hollua fare. Unë jam me atë idenë, po gjeta diçka që më rri mirë, e vesh të njëjtën gjë derisa nuk bën më. Dhe pastaj u hodh kjo bluzë, u var diku.

Kështu është dhe dashuria, apo jo? Ti gjen dikë që e do shumë, bëhesh si i çmendur për të, rri deri në 3 të mëngjesit duke shkruar me të, pastaj bajatesh dhe e hedh tutje? E var diku, nuk të intereson më?

A thua ndodh kështu edhe në martesë? Çifti thotë: "Unë të dua, do të dua derisa vdekja të na ndajë." Pastaj, sa të kalojë ca kohë, varet dashuria në raft

dhe fillon avazi: "Ti je kështu, ti je ashtu, ta kisha ditur që ishe kështu, ta kisha ditur që je kaq ashtu..."

A mos ndodh kështu edhe me shokët/shoqet? Bëhesh si i marrosur pas tyre për ca kohë, sikur është shoku/shoqja më e mirë në botë, pastaj: "Hajt se filani shkroi, s'ka gjë se i përgjigjem nesër."

A mos ndodh kështu edhe me kishën? "Ueee, kisha e ëndrrave të mira, kam ëndërruar një kishë ku të jem vetja, sa shumë e dua, kjo do jetë kisha ime, kjo do jetë kisha e familjes sime, e fëmijëve të mi." Pastaj, "hajt mo se aty është kisha, nuk ikën jo."

Ai është kështu, ajo është ashtu... po e var diku.

Kaq është dashuria? Si flakë kashte? Merr me vrull dhe *buf*, fiket? Dhe bëhet për ta varur në raft, për ta hedhur në një cep me gjërat e përdorura?

Jemi në kohë Krishtlindjeje, a thua kaq është dashuria? Krishti erdhi për të na dhënë një lloj tjetër dashurie. Le ta lexojmë te

1 Gjonit 4:7 *'Shumë të dashur, le ta duam njëri-tjetrin, sepse dashuria është nga Perëndia dhe kushdo që do, ka lindur nga Perëndia dhe e njeh Perëndinë.'*

1 Gjonit 4:8 *'Ai që nuk ka dashuri nuk e ka njohur Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri.'*

1 Gjonit 4:9 *'Në këtë është shfaqur dashuria e Perëndisë ndaj nesh, se Perëndia dërgoi Birin e tij (Krishtlindja) të vetëmlindurin në botë që ne të rrojmë nëpërmjet tij.'*

1 Gjonit 4:10 *'Në këtë është dashuria: jo se ne e kemi dashur Perëndinë, por që ai na ka dashur ne dhe dërgoi Birin e tij për shlyerjen (faljen) e mëkateve tona.'*

1 Gjonit 4:11 *'Shumë të dashur, në qoftë se Perëndia na ka dashur në këtë mënyrë; edhe ne duhet ta duam njëri-tjetrin.'*

Grimca Dashurie

Perëndia na ka dashur në një mënyrë kaq të madhe, sa që dërgoi Birin. Ne le të duam njëri-tjetrin. Nuk e di si ka qenë kjo javë për ty, por për mua, Perëndia ka krijuar shumë mundësi: të ulem të takoj njerëz, të pi kafe, të ha

diçka me ta, të marr në telefon, të shkruaj me të tjerët. Nuk ka qenë ndonjë gjë e stërmadhe. Thjesht grimca shprese, por kaq duhet. Pastaj ca grimca dashurie, gëzimi, besimi, paqeje. Sa grimca shprese ke shpërndarë? Si ishte kjo javë?

A t'u krijua mundësia për të shpërndarë shpresë aty ku ishte, në shtëpi, në punë, në shkollë, në kafe mes shoqërisë? Ngri dorën.

Kur shikon ndikimin, ti e kupton se sa e rëndësishme qenka të japësh grimca të tilla.

Le të shikojmë me nge mesazhin për sot:

Grimca Dashurie, nga pasazhi i 1 Gjonit kapitulli 4.

T'i Japim Grimca Dashurie Njëri—Tjetrit

Duket e thjeshtë kur e lexon, por është e vështirë për t'u praktikuar. Kjo i bezdisi edhe dishepujt e Jezusit.

Pjetri tha: "Duhet t'i falim njerëzit, duhet t'i duam? Po mirë, sa shumë duhet t'i falim? Hajt se po bëjmë si burra të mirë, meqë jemi me ty, Jezus. Sa herë duhet ta falim dikë që të dukemi që jemi burra *zotni*, që jemi ajka e këtij vendi?"

Sa herë tha Jezusi që duhet ta falësh dikë, kush e mban mend? Hajde e lexojmë. Ja se si mund t'i japim grimca dashurie njëri-tjetrit, në forma të thjeshta, të rëndësishme, radikale gjithashtu.

Mateu 18:21 *'Atëherë Pjetri iu afrua dhe tha: "Zot, në se vëllai im mëkaton kundër meje, sa herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?".'*

Shiko, po flet për rrethin e ngushtë, jo për botën e madhe, por për ata rreth e qark teje: familja, vëllai, motra, rrethi i ngushtë. Dhe shiko, ligji e kishte kështu: maksimumi që mund të falësh dikë ishte 3 herë. Po e përsëriti herën e 4-t, bëj namin, sepse e kaloi cakun. "Po kalove 3 herë, unë të hedh tutje, si bluzë e vjetër. Nuk të var as në raft, jo, të hedh te koshat e mbeturinave të bashkisë. Kaq, 3 herë, s'të duroj dot më shumë. Herën e 4-t, i lava duart me ty."

Kur Pjetri tha 7 herë, ai po bënte si burrë i mirë: nga 3 në shtatë, sa i bie, dyfish 3+3 dhe 1 bonus bëjnë 7. Por Jezusi i tha:

Mateu 18:22 *'Jezusi i tha: "Unë nuk të them deri shtatë herë, por deri*

shtatëdhjetë herë shtatë.'

Wow, ca thotë Jezusi?

Shiko, Jezusi nuk po nënkupton: "merr lapës e letër dhe llogarit, i bëre 39 kujdes, i kalove 45 kujdes."

Jo, jo, ai po nënkuptonte: numri është aq i madh për të falur në një ditë, sa që mos e merr fare mundimin për të numëruar faljet e tua. Dhe për ta ilustruar këtë, Jezusi tregon një histori radikale, ekstreme fare.

Por ama, duket qartë që ajo që duhet të bënte dikush për shokun e tij, për tjetrin, ishte thjesht disa grimca dashurie dhe falje, ajo që pritej prej tij.

Mateu 18:23 *'Prandaj mbretëria e qiejve i ngjan një mbreti që deshi të bënte llogaritë me shërbëtorët e vet.'*

E di si ngjan, dhe Jezusi e krahasoi me termat e asaj kohe. Ishte koha e mbretërisë, dhe Perëndinë e krahasoi me një mbret dhe ne si shërbëtorët e këtij mbreti.

Mateu 18:24 *'Mbasi filloi t'i bëjë llogaritë, i sollën një që i detyrohej dhjetë mijë talenta.'*

Mateu 18:25 *'Dhe, duke qenë se ky nuk kishte të paguante, zotëria e tij urdhëroi që të shitej ai me gruan e tij, bijtë e tij dhe gjithë ç'kishte, dhe të shlyejë detyrimin.'*

Mateu 18:26 *'Atëherë ai shërbëtor i ra ndër këmbë e i lutej duke thënë: "Zot, ki durim me mua dhe unë do t'i paguaj të gjitha".'*

Mateu 18:27 *'I shtyrë nga dhembshuria, zotëria e atij shërbëtori e la të lirë atë dhe ia fali detyrimin.'*

Ia fali detyrimin, e la të shkonte, të lirë, të falur. Ajo që thotë ky pasazh: Së pari, ne i kemi borxhe Perëndisë, që janë mëkatet tona që kemi bërë ndaj Tij. Dhe shuma që i detyrohemi Perëndisë është e madhe.

Ajo shumë 10.000 talente që përmendi Jezusi, ishte një shumë që nuk kishte njeri në botë që mund ta paguante, çfarëdo që të bënte, nuk e arrinte dot. Ja të bëjmë një llogari: 1 talent peshonte mbi 30 kg flori, 10 mijë talenta janë 300.000 kg flori. Po shikoja në Google sa është 1 kg flori dhe ishte diku te 50.000 euro për kg. 300.000 kg herë 50.000 euro del një shumë me shumë zero, 15 me 9 zero euro.

Jezusi po ilustron idenë: shërbëtori i ka aq borxh mbretit, saqë nuk ka shanse në botë që t'i paguajë. Perëndia thotë të njëjtën gjë për ne.

Ne e kemi tepruar aq shumë para Tij, sa ç'të thuash, as që numërohen sa shumë jemi në borxh para Tij.

Ja ta rrëfej një mëkat: E shikon këtë çelësin? Para 15 vitesh, kur isha me shtëpi në një lagje tjetër, ai që më kishte dhënë shtëpinë me qira, ishte derë më derë me mua. Shumë burrë i mirë. Dhe kur më prishej ndonjë gjë te banjo, i kërkoja çelësin, e rregulloja dhe ia jepja çelësin. Konsumohej ndonjë nga ato tubat e banjos, e ndërroja. Pastaj ia jepja çelësin, prishej prapë diçka, ia merrja prapë. Tani, mbas ca radhësh, harrova t'ia jepja çelësin. Dhe ne ikëm me shtëpi te lagjja që jemi tani. Dhe një ditë shikoj çelësin, *ueee, po ky është çelësi i Sazanit*. E takoj një ditë, rastësisht dhe i thashë, ta kam vjedhur një çelës më duket. Ai qeshi, "e di, e di, atë çelësin që merrje gjithmonë, por ta kam falur, mbaje."

A ke bërë gjëra të tilla ti? Ke marrë ndonjë gjë që s'të takonte dhe ke harruar ta ktheje? *Hajt, ska gjë, se nuk e ka mendjen. Hajt, se s'do e kujtojë.* Duhaxhinjtë, sa cakmakë keni vjedhur padashje? Apo i keni marrë me dashje?

Ose stilolapsa në punë, gjëra të vogla.

Shiko, po përmendim gjërat e vogla, nuk po hyjmë në detaje në gjëra më të thella. Se pastaj, po të bëjmë inventarin, na del shuma 10.000 talenta borxh të gjithëve.

Dhe shërbëtori, kthehemi te pasazhi, i ra në gjunjë mbretit dhe i tha: "Ki durim me mua, unë do t'i paguaj të gjitha."

Kjo është qesharake, e di pse? Sepse nuk mundej ta paguante atë shumë aq të madhe. Kështu bëjmë edhe ne me Perëndinë, apo jo? *Zot, më fal këtë herë, po më fale këtë herë, do ta shpërblej herën tjetër. Do lexoj Biblën më gjatë, do lutem më gjatë, do shkoj në kishë më shpesh, do jap më shumë te koshi.*

Shiko, ndoshta gjërat e mira që mund të bësh ti në jetë, sado që të jenë, nuk afrohen me atë që i ke borxh Perëndisë. Dhe mbreti i dashur, i dhembshur, i shtyrë nga dashuria e fali borxhliun. Kjo nuk është dashuri me grimca, është dashuri me tonelata.

Ndonjëri po thotë: "Po ç'lidhje ka kjo? Ti the që ka të bëjë me faljen e njëri-tjetrit." Jezusi kështu e filloi historinë e faljes: Para se të falim dikë, le të shikojmë sa na ka falur ne Perëndia. Të gjithë kemi nevojë për faljen e Tij,

s'bëjmë dot pa të.

Psalmet 130:3 *'Në rast se ti do të merrje parasysh fajet, o Zot, kush mund të rezistonte, o Zot?'*

Tani kthehemi te pjesa e 2-të e historisë:

Mateu 18:28 *'Por ai shërbëtor, si doli, takoi një nga shërbëtorët e tjerë, që i detyrohej njëqind denarë; dhe, mbasi e zuri për fyti, po e mbyste duke thënë: "Më paguaj detyrimin që më ke".'*

100 denarë ishin sa 100 ditë pune (1 denar=1 ditë pune).

Mateu 18:29 *'Atëherë shërbëtori shok i tij, i ra ndër këmbë dhe iu lut duke thënë: "Ki durim me mua, dhe do t'i paguaj të gjitha".'*

A të duket e njohur kjo kërkesa?

Mateu 18:30 *'Por ai nuk deshi, madje shkoi dhe e futi në burg derisa ai ta shlyente detyrimin.'*

Mateu 18:31 *'Por shërbëtorët e tjerë, kur e panë ngjarjen, u pikëlluan shumë dhe shkuan e i thanë zotërisë së tyre gjithçka që kishte ndodhur.'*

Shpesh e shikojmë kur të tjerët gabojnë, por cilën kemi të vështirë të shikojmë? Kur gabojmë vetë! A bie dakord edhe ti me mua? Kur bëjnë gabime të tjerët, i dallojmë dhe i analizojmë. Tonat, jo. S'na i kap syri tonat.

Mateu 18:32 *'Atëherë zotëria e tij e thirri dhe i tha: "Shërbëtor i lig, unë ta fala gjithë këtë detyrim, sepse m'u lute.'*

Mateu 18:33 *'A nuk duhej të kishe mëshirë edhe ti për shokun tënd, ashtu si pata mëshirë unë për ty?'''*

Uhuuu, a nuk duhet të kishe mëshirë edhe ti, sikur pata unë për ty? Ajo që të ka borxh shoku yt janë thjesht disa grimca falje, disa grimca dashurie po të kërkohej, ndërkohë që ty t'u fal një sasi shumë e madhe.

Mateu 18:34 *'Dhe zotëria i tij, i zemëruar, ua dorëzoi torturuesve derisa të paguante gjithë detyrimin.'*

Mateu 18:35 *'Kështu do të veprojnë me ju edhe Ati im qiellor, në qoftë se secili prej jush nuk e fal me gjithë zemër vëllanë e vet për fajet e tij.'*

Mbyllje e trishtuar, por a e dallove sa peshë ka falja dhe mos falja? Jezusi e dinte që kështu jemi ne. Për vete duam mëshirë nga Perëndia, duam

dhembshuri, duam dashuri dhe falje nga Perëndia. Kurse për të tjerët, duam drejtësi.

Kur të bëhet një padrejtësi, të vlon gjaku, ti do drejtësi, ti s' do falje. Jezusi po flet për rrethin e ngushtë. Kur të bëhet padrejtësi nga familja, nga shokët, në martesë, fejesë, lidhje, nga kolegu apo dikush i afërt që i beson me jetën tënde, bëhet më e vështirë.

Por ajo që po na kërkon Jezusi të bëjmë për dikë, duke e falur, janë thjesht disa grimca dashurie, falje. Kaq.

Prandaj tha Pjetri më vonë në jetën e tij te:

1 Pjetrit 4:18 *'Dhe "nëse i drejti mezi shpëton, ku do të duket i pabesi dhe mëkatari?'*

Sa? Një shumicë të madhe mëkatesh. Grimca dashurie mbulojnë shumicën e mëkateve. *Kujt i thua ti ta fal? A e di çfarë më ka thënë ajo? A e di çfarë i ka thënë shoqes sime, motrës, vëllait, mamit? A e di ti se çfarë më shkroi në WhatsApp, në Viber? Ku ka dashuri, unë se di ku e ka shtëpinë dashuria. Por e di ku e ka shtëpinë drejtësia, do ia drejtoj kurrizin.*

Shiko, kur vjen puna te marrëdhëniet, lidhjet, fejesat, martesat, këto tre gjëra mos i harroni. Shiko, bëra 17 vite martuar me gruan time. Njeriu ose mëson duke dëgjuar ose duke pësuar. Ju bëhuni të mençur, mësoni duke dëgjuar, jo duke pësuar. Cilat janë?

1.Qesh me gafat e tua. Mos e merr veten aq seriozisht. Qeshni me gafat e njëri-tjetrit. *E mban mend kur ishim atje, kur na iku autobusi, kur më vodhën kuletën, kur na u prish makina, kur nuk e hape telefonin edhe pse kishte rënë 250 herë?* Mos bëj interesantin kot, nuk ka njeri të përsosur, as ti nuk je i përsosur, kështu që qeshni me gafat e njëri-tjetrit, në vend që të numëroni fajet e njëri-tjetrit.

Para një muaji kishim 17 vjetorin e martesës. Dhe çfarë ndodhi, unë dhe gruaja ime ishim me nerva me njëri-tjetrin. Dolëm për darkë te një restorant i lagjes. Dhe po e gjete ç'muhabete bëmë? Po kujtonim gafat që kishim bërë këto 17 vjet, dhe kishim shumë material. Nuk folëm për asgjë tjetër dhe mendoj që ishte një nga **date nights** më të bukura që kemi pasur. Qeshëm me gafat tona.

2.Hiq dorë nga gjërat e vogla para se të marinohen. Se po u marinuan, duken të mëdha, të stërmëdha. Fali shpejt edhe pa të kërkuar falje. Sepse

dashuria mbulon një shumicë mëkatesh. Grimca dashurie, që falin gabimet e vogla të përditshme.

Ja ku i la këpucët, ja si e la pjatën, ja ku e la furçën, asnjëherë nuk e ngre kapakun e wc së banjës, e le derën hapur, lavamanin pis. Pse hap celularin, pse nuk më shkrove kur të shkrova, pse pe, pse nuk më pe.

Auuuu, gjërat e vogla, hiq dorë shpejt, fal shpejt, mos i marino, sepse po u zmadhua bëhet e vështirë. Fali edhe pa të kërkuar falje. Hiq dorë, mos bëj sikur ti je partneri ideal, sikur ti je engjëll i rënë nga qielli, sikur ti je perri, ai/ajo është djalli me brirë. Në fakt, në lidhje asnjëri s'është i përsosur. Lum kush fal i pari. Para se të kthehet në gjëmë të madhe. Ndryshe do lodhesh shpejt dhe do varësh bluzën në raft.

3.Jep falje edhe pasi je lënduar. Ka ca gjëra, ndodhin ca gjëra, edhe pse ti po mundohesh për të pasur harmoni në familje, harmoni në fejesë, lidhje, mes shokësh, ndodh lëndimi. Ai bëri filan gjë dhe të lëndoi thellë. Ajo bëri filan gjë dhe të lëndoi thellë.

Ulu dhe flisni bashkë dhe faleni njëri-tjetrin. Nuk ka lidhje që mund të shkojë gjatë pa këto të treja, nuk ka fejesë, martesë, miqësi, shoqëri që mund të shkojë gjatë pa këto të treja, fiksoji mirë. Nëse mbledh hidhërim dhe zemërim, mos sot, mot do plasë, dhe do të lëndojë ty dhe personin me të cilin je.

Nëse ke filluar të mbash llogari: "Ti ma bëre kështu atë ditë, ti më the kështu atë natë, ti më the kështu te klasa, te puna, te dreka." Nuk ka gjasa të ecë mirë ajo marrëdhënie nëse dikush po mbledh gabimet.

Gabimet janë si mbeturina. Nëse dikush po mbledh gabimet, po kthehet në kosh mbeturinash, që do qelbet një ditë dhe do plasë. Mbeturinat hiqen çdo ditë nga shtëpia, ndryshe nuk rrihet më në shtëpi.

Grimca dashurie, grimca falje, ti ke nevojë për t'i dhënë çdo ditë njerëzve me të cilët je i afërt, jeton, punon, je i ngushtë me ta.

Shiko, po nuk fale të tjerët, nuk e ke mirë as me të tjerët, as me Perëndinë. Fal të tjerët ashtu siç Perëndia të ka falur ty, pa kushte.

Si i ke marrëdhëniet? Si është gjendja te familja jote, puna jote, shkolla, shoqëria? Aty ku je ti?

Poooo mor po, e di që ti je rrethuar me njerëz të vështirë, po po e di, që

s'kuptojnë, po po e di, që janë egoistë, që janë kështu e ashtu, po po, e di, e di.

Grimca dashurie po themi, jo një kazan me dashuri, grimca falje, dashurie, kujdesi. Dashuria mbulon shumicën e mëkateve.

Kush fal dhe jep dashuri, është person që ka marrë falje dhe dashuri. Edhe në kishë ndodh që mund të lëndohesh. *Çfarë thua*, po thotë ndonjë i ri. Po po, nëse rri gjatë, mbi 1 vit, është e sigurt që do të thotë dikush një fjalë më shumë, një lëndim pa dashje a me dashje. Je rrethuar nga njerëz që s'janë perfektë dhe pritjet le të jenë të tilla.

Me kalimin e viteve kam mësuar këtë gjë, që ia them Perëndisë: **"Zoti im, nëse Ti mund të më falësh mua, unë mund ta fal atë person. Përderisa marr falje, unë jap falje."**

Nëse më duhet mëshirë, falje, dashuri nga Perëndia, atë duhet t'ua jap të tjerëve gjithashtu.

A je lënduar në kishë? Atëherë fal.

A e ke lënduar ti kishën? Me shumë gjasa, po. Atëherë ashtu siç do falje, jep falje.

Sa herë ke thënë që do vij dhe s'ke ardhur? Që do japësh dhe s'ke dhënë? Që do shërbesh dhe vetëm pret të të shërbejnë? A ke folur pas shpine, thashetheme? *A e pe, a e dëgjove?* Nënvlërësim ndaj pastorëve, drejtuesve? Nuk jep të dhjetën, kështu që kisha nuk bën dot atë që duhet të bëjë. Mund ta vazhdoj listën. E vërteta është...

Ti pret që të gjithë të të kuptojnë dhe të të falin ty, por ti s'do të falësh dhe të kuptosh të tjerët. Ky është ose egoizëm ose papjekuri. Kisha duhet të jetë vendi ku themi: Përderisa Perëndia më ka falur mua, unë fal të tjerët.

Fiks para kësaj historie, te kapitulli 18, Jezusi flet për tensionet e tilla:

Mateu 18:15 *"Por në qoftë se vëllai yt ka mëkatuar kundër teje, shko dhe qortoje vetëm për vetëm; në qoftë se të dëgjon, ti e fitove vëllanë tënd;"*

Mateu 18:16 *'por në qoftë se nuk të dëgjon, merr me vete edhe një ose dy vetë, që çdo fjalë të vërtetohet nga goja e dy ose tre dëshmitarëve.'*

Mateu 18:17 *'Në se pastaj refuzon t'i dëgjojë, thuaja kishës; dhe në qoftë se refuzon edhe ta dëgjojë kishën, le të jetë për ty si pagan ose tagrambledhës.'*

Ka një lloj përgjegjësie, ka një lloj respekti, një lloj radhe thotë shkrimi.
Ashtu siç Perëndia na fal ne, ne falim të tjerët.

Nuk ka kishë që është e përsosur, madje nëse gjen ndonjë kishë të përsosur,
mos shko ti tek ajo kishë, sepse pasi të kesh shkuar ti, nuk është më e
përsosur. Sepse asnjë nga ne nuk është i përsosur.

Ne kemi nevojë për një kishë që flet për falje, që e praktikon faljen, sepse e
di që është dashur, ka marrë dashuri dhe është falur, ka marrë falje pa kushte
nga Perëndia.

Nëse do radhisim gabimet e njëri-tjetrit, do të dalë llogaria keq, sepse ke
shumë zero minus te llogaria jote e faljes para Perëndisë.

Ty të duhet një kishë që di të japë grimca dashurie, një që ka përjetuar faljen
dhe di të falë. Kisha janë njerëzit, kisha jonë je ti, kështu që a do japësh
grimca dashurie këtë javë?

Kë të solli Perëndia në mendje?

Kë duhet të falësh?

Çfarë do të bësh konkretisht këtë javë për ta falur dhe dashur atë person?

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.